



**VENDIM**  
**Nr. 66, Datë 11.05.2017**

**MBI**  
**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LËNIEN PENG TË ASETETEVE TË**  
**SHOQËRISË “ALB ENERGY” SH.P.K, NË FAVOR TË BANKËS**  
**“SOCIETE GENERALE ALBANIA” SH.A.**

Në mbështetje të neneve 16; 20 pika “a”; 44, pika 1, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 6; 7 dhe 8 të “Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, gjithashtu dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.05.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi kërkesën e shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k, për lënien peng të asetëve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

**Konstatohet se:**

ERE me Vendimin nr.56, datë 18.04.2017, ka filluar procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k, për lënien peng të asetëve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a..

Aplikimi i shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit” si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gërmat:
  - “a” ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit, është plotësuar;
  - “b”- veprimtaria e licensuar, është plotësuar;
  - “c” - gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve, është plotësuar;

- “**d**”-përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare, është plotësuar;
- “**e**”- arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit, është plotësuar;
- “**f**”-efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit, është plotësuar;
- “**g**”-efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifatat e aktivitetit të licencuar, është plotësuar;
- “**h**” -marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja përmban një listë të detajuar të asetëve që kërkohet të transferohen, është plotësuar;
- “**i**”- deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit, është plotësuar;
- “**j**”(Nëse ka patur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt) është plotësuar;

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

#### **Vendosi:**

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “ Alb Energy“ sh.p.k, për lënien peng të asetëve në favor të Bankës “Societe Generale Albania”sh.a.( lista bashkëlidhur)
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE**

**Petrit AHMETI**

**ASETET QË SHOQËRIA “ALB ENERGY” SH.P.K, KA KËRKUAR TË  
LËRË PENG NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE GENERALE  
ALBANIA” SH.A,**

a) Çertifikatë nr. 548628; përshkrimi i pasurisë:

Hec “BELE 2” disponon ndërtesën me  $S= 609m^2$  ,

Tubacion 1502m

Vepra e marrjes sip= $235m^2$

Sipërfaqe trualli = $16.594 m^2$ ,

b) Çertifikatë nr. 548626; përshkrimi i pasurisë:

“Hec Topojan 1” disponon ndërtesën  $S= 372m^2$  ,

Tubacion 1502m

Sipërfaqe trualli,  $S =4641 m^2$ ,

c) Çertifikatë nr. 548650; përshkrimi i pasurisë:

Nënstacion,  $S =932m^2$